



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3603 / Prot
2

Gramsh më 13.10.2020

V E N D I M

Nr. 67, datë 30.09 /2020

P Ë R

MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE NË KULTURAT BLEGTORALE
TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSI NATYRORE PËR FAMILJEN E Z. TELE
KUMRIA, DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË GRAMSH.


Këshilli i Bashkisë Gramsh, në mbledhjen e tij të datës **30.09.2020**, pasi shqyrtoi kërkesën e shtetasit Tele Kumria si dhe relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve në kulturat blegtorale të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore për familjen e z. Tele Kumria, dhe shpërblimin financiar nga ana e bashkisë mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh; Ligjin Nr.45/2019, datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr.95, datë 30.12.2019”Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2020’, i ndryshuar:

V E N D O S I:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve në kulturat blegtorale të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore për familjen e Z. Tele Kumria, ndodhur në fshatin Broshtan, NJA Kodovjat, në datën 10.06.2020 , përkatësisht në masën:
 - 100.000 (njëqind mijë) lekë.
2. Ndihma financiare do të përballohet nga fondi i emergjencave i Bashkisë Gramsh.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e të Ardhurave, Zhillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes se tij.

**SEKRETARI I KËSHILLIT
ENDRI MEMA**



Konceptoi: E. Mema

Pranoi: G. Lena

Miratoi: G. Lena

Dosja nr: _____

Afati i ruajtjes: _____

**KRYETARI I KËSHILLIT
GRETA LENA**

